



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 19.06.2025, me lende: Kërkesë për informacion dhe venie në dispozicion dokumentacioni, administruar në bashkinë Shkodër me nr.12367.prot hyres, datë 19.06.2025, bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar; ligjin nr.93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, VKM nr. 649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret të ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar, Ju informojmë si vijon:

Në lidhje me pikat 1 dhe 2 sipas kërkesës bashkelidhur, mendojmë se duhet ti drejtohet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, duke qenë ato institucioni përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave si dhe të lidhjes së kontratave me subjektet të cilët shfrytëzojnë stacionet e plazhit. Në lidhje me pikat nr. 3,4 dhe 5, ju informojmë që në territorin administrativ të bashkisë Shkodër hapësira e plazheve publike të menaxhueshme, administrohet dhe mirëmbahet nga Shoqëria Aksionere me nipt M369240030, me kapital publik, 100% në pronësi të bashkisë Shkodër, bazuar në të drejtën e dhënë nga Këshilli Bashkiak Shkodër me vendimin nr.29, datë 29.05.2025.

Në lidhje me pikën 6 të kërkesës, ju informojmë që Shoqëria ka të drejtën e menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes për sipërfaqet e plazhit të percaktuara në nenin 3 pika 2 dhe në nenin 4, pika 6 të VKM nr. 649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar, ku citon.....neni 3 pika 2. Hapësirat e plazheve të lejuara, të cilat nuk janë dhënë në përdorim për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit janë për përdorim publik dhe administrohen, menaxhohen e mirëmbahen nga njësi e vetëqeverisjes vendore. neni 4, pika 6.....Plazhet, për të cilat nuk është lidhur kontratë deri në datën e përcaktuar në pikën 5, të këtij neni, funksionojnë si plazhe publike dhe administrohen/menaxhohen e mirëmbahen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Bashkelidhur vendimi i Këshillit Bashkiak Shkodër me nr.29, datë 29.05.2025.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin

KRYETAR

Benet Beci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10931 prot.

Shkodër, më 30.5. 2025

VENDIM

Nr. 29, datë 29.05.2025

**“PËR DHËNIEN E TË DREJTËS DHE CAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
MENAXHIMIT, ADMINISTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PLAZHEVE PUBLIKE
TË MENAXHUESHME PËR SHOQËRINË AKSIONERE NË PRONËSI TË BASHKISË
SHKODËR ME NIPT M36924003O”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139, datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar; VKM-së Nr.649, datë 16.10.2024 “Për Miratimin e Rregullores për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”, neni 4; VKB-së nr. 15, datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca sh.a, si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratohet dhënia e së drejtës dhe caktimi i përgjegjësisë për menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e plazheve publike të menaxhueshme, sipas VKM-së nr. 649, datë 16.10.2024, shoqërisë aksionare me NIPT M36924003O.
2. Afati për të cilin i jepet e drejta dhe i caktohet kjo përgjegjësi do të jetë 5 (pesë) vjet, sipas hartës së përditësuar ndër vite.
3. Shoqëria aksionare me NIPT M36924003O do ta ushtrojë këtë veprimtari sipas kriterëve dhe përcaktimeve ligjore në fuqi.
4. Shoqëria aksionare me NIPT M36924003O nuk ka të drejtë t’ia japë këtë hapësirë me qira palëve të treta apo ta shfrytëzojë bashkërisht me operatorë të tjerë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 28 vota

Vota Pro	28
Vota Kundër	13
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	30.05.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

